



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -*  
*Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth and Sports*

---

**DRAFT RREGULLORE (MKRS) NR. XX/2023 PËR DETYRAT, PËRGJEGJËSITË, PËRBËRJEN,  
MËNYRËN E ZGJEDHJES DHE KOMPENSIMIN E JURIVE VLERËSUESE DHE KOMISIONEVE**

**DRAFT REGULATION (MCYS) NO. XX/2023 ON DUTIES, RESPONSIBILITIES, COMPOSITION,  
METHOD OF SELECTION AND COMPENSATION OF EVALUATING JURIES AND COMMISSIONS**

**NACRT UREDBE (MKOS) BR. XX/2023 O DUŽNOSTIMA, ODGOVORNOSTIMA, SASTAVU, NAČINU  
IZBORA I KOMPENZACIJI ŽIRIJA I KOMISIJA ZA OCENJIVANJE**

<p><b>Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,</b></p> <p>Në mbështetje të nenit 16, paragrafit 2, të Ligjit Nr. 08/L-202 për Kinematografinë, (Gazeta Zyrtare Nr. 16 / 6 korrik 2023), nenit 11, paragrafit 1.5, të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, dhe nenit 38, paragrafit 6, të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15, 12.09.2011),</p> <p>Nxjerr:</p> <p><b>RREGULLORE (MKRS) NR. XX/2023 PËR DETYRAT, PËRGJEGJËSITË, PËRBËRJEN, MËNYRËN E ZGJEDHJES DHE KOMPENSIMIN E JURIVE VLERËSUESE DHE KOMISIONEVE</b></p> <p><b>Neni 1 Qëllimi</b></p> <p>Kjo rregullore përcakton rregullat për mënyrën e emërimit të jurive vlerësuese dhe komisioneve, procesin e punës, mënyrën e vendimmarrjes, të votimit, të përzgjedhjes dhe të aprovimit të projekteve filmike dhe audio-vizuale të</p>	<p><b>Minister of the Ministry of Culture, Youth and Sports,</b></p> <p>Pursuant to Article 16 paragraph 2 of Law No. 08/L-202 on Cinematography, (Official Gazette No. 16 / July 6, 2023), article 11 paragraph 1.5 of Law No. 08/L-117 on the Government of the Republic of Kosovo, and article 38, paragraph 6, of the Rules of Procedure of the Government of the Republic of Kosovo No. 09/2011 (Official Gazette No. 15, 12.09.2011),</p> <p>Issues:</p> <p><b>REGULATION (MCYS) NO. XX/2023 ON DUTIES, RESPONSIBILITIES, COMPOSITION, METHOD OF SELECTION AND COMPENSATION OF EVALUATING JURIES AND COMMISSIONS</b></p> <p><b>Article 1 Purpose</b></p> <p>This Regulation shall define the rules with regard to the method of appointing evaluating juries and commissions, the work process, the method of decision-making, voting, selection and approval of film and audiovisual projects subsidized</p>	<p><b>Ministar Ministarstva kulture, omladine i sporta,</b></p> <p>Na osnovu člana 16. stav 2. Zakona br. 08/L-202 o Kinematografiji, (Službeni list br. 16/ 6. jul 2023), člana 11, stav 1.5, Zakona br. 08/L-117 o Vladi Republike Kosovo, i člana 38, stav 6 Pravilnika br. 09/2011 o Radu Vlade Republike Kosovo (Službeni list br. 15, 12.09.2011),</p> <p>Izdaje:</p> <p><b>UREDBE (MKOS) BR. XX/2023 O DUŽNOSTIMA, ODGOVORNOSTIMA, SASTAVU, NAČINU IZBORA I KOMPENZACIJI ŽIRIJA I KOMISIJA ZA OCENJIVANJE</b></p> <p><b>Član 1 Cilj</b></p> <p>Ovom uredbom definišu se pravila o načinu imenovanja žirija za ocenjivanje i komisija, proces rada, način odlučivanja, glasanja, selekcije i odobravanja filmskih i audio-vizuelnih projekata koje subvencioniše Kinematografski centar</p>
--	---	---

<p>subvencionuara nga Qendra Kinematografike e Kosovës (më tutje QKK).</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 2 Fushëveprimi</b></p> <p>Dispozitat e kësaj rregulloreje përfshijnë mënyrën e ecurisë së realizimit të projekteve të mbështetura nga QKK-ja, detyrat, përgjegjësitë, përbërjen, kompensimin dhe mënyrën e zgjedhjes së jurisë vlerësuese dhe komisioneve.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Përkufizimet</b></p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. <b>QKK</b> – nënkupton Qendrën Kinematografike të Kosovës;</p> <p>1.2. <b>Drejtori</b> – nënkupton drejtorin e Qendrës Kinematografike të Kosovës;</p> <p>1.3. <b>Komisioni i konkursit</b> – nënkupton komisionin administrativ që vlerëson dokumentacionin teknik të projekteve;</p>	<p>by the Kosovo Cinematography Center (hereinafter KCC).</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 2 Scope</b></p> <p>The provisions of this Regulation shall include the progress of the project implementation supported by the KCC, the duties, responsibilities, composition, compensation and the selection of the Evaluating Jury and commissions.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 3 Definitions</b></p> <p>1. Expressions used in this Regulation have the following meaning:</p> <p>1.1. <b>KCC</b> – means the Kosovo Cinematography Center;</p> <p>1.2. <b>Director</b> – means the director of the Kosovo Cinematography Center;</p> <p>1.3. <b>Competition commission</b> - means the administrative commission that evaluates the technical documentation of the projects;</p> <p>1.4. <b>Financial commission</b> – means</p>	<p>Kosova (u daljem tekstu KCK).</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 2 Delokrug</b></p> <p>Odredbe ove uredbe obuhvataju način toka implementacije projekata podržanih od KCK-a, dužnosti, odgovornosti, sastav, naknade i način izbora žirija za ocenjivanje komisija.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 3 Definicije</b></p> <p>1. Izrazi koji se koriste u ovoj uredbi imaju ovo značenje:</p> <p>1.1. <b>KCK</b> – podrazumeva Kinematografski centar Kosova;</p> <p>1.2. <b>Direktor</b> – podrazumeva direktora Kinematografskog centra Kosova;</p> <p>1.3. <b>Konkursna komisija</b> – podrazumeva administrativnu komisiju koja ocenjuje tehničku dokumentaciju projekata;</p>
--	--	--

1.4. **Komisioni financiar** – nënkupton komisionin tekniko-financiar, i cili vlerëson buxhetet e projekteve;

1.5. **Juritë vlerësuese** – nënkupton juritë të cilat përzgjidhen për të bërë vlerësimin përmbajtjesor të projekteve të konkurseve për subvencionimin e projekteve filmike;

1.6. **Komisioni i kategorizimit** – nënkupton autoritetin shtetëror, në kuadër të QKK-së, që jep leje për shfaqje publike dhe kategorizim, sipas përshtatshmërisë për shfaqje publike të veprave filmike apo audio-vizuale të prodhuara në Republikën e Kosovës.

#### **Neni 4 Komisioni financiar**

1. Projektet e përzgjedhura i nënshtrohen vlerësimin tekniko-financiar nga komisioni financiar, i cili ka përgjegjësinë të shqyrtojë dhe të vlerësojë buxhetin e projekteve, nëse i njëjti është hartuar në përputhje me rregullat dhe standardet e planifikimit buxhetor, duke pasur për bazë dokumentin i cili parasheh minimumin dhe maksimumin e mbështetjes financiare të një pozicioni të caktuar në film (çmimorja). Ky dokument do të jetë pjesë

the technical-financial commission that evaluates project budgets;

1.5. **Evaluating juries** - means the juries that are selected to make the content evaluation of the projects of the competitions for subsidizing film projects;

1.6. **Categorization Commission** - means the state authority within the KCC, that grants permission for public screening and categorization, according to suitability for public screening of film or audio-visual works produced in the Republic of Kosovo.

#### **Article 4 Financial Commission**

1. Selected projects are subject to technical-financial evaluation by the financial commission, which has the responsibility to review and evaluate the project budget whether it has been drawn up in accordance with the rules and standards of budget planning, based on the document that foresees the minimum and maximum value of the financial support for a certain position in a film (price list). This document shall be an integral

1.4. **Finansijska komisija** – podrazumeva tehničko-finansijska komisija, koja ocenjuje budžete projekta;

1.5. **Žiri za ocenjivanje** – podrazumeva žirija koji se biraju da izvrše sadržajnu ocenu projekata konkursa za subvencionisanje filmskih projekata;

1.6. **Komisija za kategorizaciju** - označava državni organ, u okviru KCK-a, koji izdaje dozvolu za javno prikazivanje i kategorizaciju, prema podobnosti za javno prikazivanje filmskih ili audio-vizuelnih dela proizvedenih u Republici Kosovo.

#### **Član 4 Komisija za finansije**

1. Selektovani projekti podležu tehničko-finansijskoj oceni finansijske komisije e, koja ima odgovornost da pregleda i oceni budžet projekta, ako je isti izrađen u skladu sa pravilima i standardima planiranja budžeta, a na osnovu dokumenta koji predviđa minimalna i maksimalna finansijska podrška određene pozicije u filmu (cenovnik) (iznos finansijske podrške za određenu poziciju u filmu) . Ovaj dokument će biti sastavni

<p>përbërëse e këtij akti nënligjor.</p> <p>2. Komisioni financiar përbëhet prej 3 anëtarëve të cilët emërohen nga drejtori i QKK-së.</p> <p>3. Komisioni financiar komunikon me jurinë vlerësuese, ashtu siç përcaktohet në nenin 12 të kësaj rregulloreje.</p>	<p>part of this sub-legal act.</p> <p>2. The financial commission shall consist of 3 members and they are appointed by the Director of KCC.</p> <p>3. The Financial Commission shall communicate with the Evaluating Jury, as defined in Article 12 of this Regulation.</p>	<p>deo ovog podzakonskog akta.</p> <p>2. Finansijska komisija se sastoji od 3 člana koje imenuje direktor KCK.</p> <p>3. Finansijska komisija komunicira sa žirijem za ocenjivanje, u skladu sa članom 12. ove uredbe.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Juritë vlerësuese dhe emërimi i tyre</b></p> <p>1. Juritë vlerësuese bëjnë vlerësimin përmbajtjesor të projekteve filmike dhe audio-vizuale të pranuar në konkurset publike të shpallura nga QKK-ja.</p> <p>2. Juritë vlerësuese propozohen nga drejtori i Qendrës Kinematografike të Kosovës në bashkëpunim me Këshillin profesional dhe emërohen nga ministri brenda 15 ditësh nga data e përfundimit të vlerësimit administrativ nga komisioni i konkurseve.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>Evaluating juries and their appointment</b></p> <p>1. The evaluating juries shall evaluate the content of the film and audiovisual projects received in the public competitions announced by the KCC.</p> <p>2. The evaluating juries are proposed by the director of the Kosovo Cinematography Center in cooperation with the Professional Council and are appointed by the Minister within 15 days from the date of completion of the administrative evaluation by the competition commission.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 5</b> <b>Žiri za ocenjivanje i njihovo imenovanje</b></p> <p>1. Ocenjivački žiri vrši suštinsku ocenu sadržaj filmskih i audio-vizuelnih projekata prijavljenih na javnim konkursima koje raspisuje KCK.</p> <p>2. Žirije za ocenjivanje se predlažu od strane direktora Kinematografskog centra Kosova u saradnji sa Stručnim savetom i imenuje ih ministar u roku od 15 dana od dana završetka administrativnog ocenjivanja od strane konkursne komisije.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Përbërja e jurive vlerësuese</b></p> <p>1. Juritë vlerësuese përbëhen nga pesë (5) anëtarë dhe dy (2) anëtarë të tjerë rezervë,</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Composition of evaluating juries</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 6</b> <b>Sastav ocenjivačkih žirija</b></p> <p>1. Ocenjivački žiri čine pet (5) članova i još dva (2) rezervna člana, istaknute</p>

personalitete të shquara nga fusha e kinematografisë: regjisorë, producentë, aktorë, skenaristë, montazherë, drejtorë fotografie, kritikë letrarë, kritikë të filmit, kompozitorë, shkrimtarë, publicistë, kineastë e të tjerë, të cilët mund të jenë vendas dhe ndërkombëtarë.

2. Përbërja e jurive e vlerësuese publikohet në faqen zyrtare të QKK-së.

#### **Neni 7**

##### **Njoftimi i anëtarëve të jurisë vlerësuese lidhur me konfliktin e interesit**

1. Anëtarët e jurisë vlerësuese paraprakisht paralajmërohen për kufizimet, të cilat rrjedhin nga ligjet në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit, si dhe për emrat e aplikuesve dhe autorët pjesëmarrës në konkurs.

2. Nëse në një kategori të konkursit përkatës konstatohet se ka apo mund të ketë konflikt interesi te një apo dy anëtarë të jurisë të njëjtit përjashtohen nga vlerësimi dhe diskutimi për kategorinë përkatëse dhe nuk kompensohen për punën e tyre në atë kategori.

1. The evaluation juries shall consist of five (5) members and two (2) other reserve members, prominent personalities from the field of cinematography: directors, producers, actors, screenwriters, editors, directors of photography, literary critics, film critics, composers, writers, publicists, other filmmakers, who can be local and international.

2. The composition of evaluating juries shall be published on the official website of the KCC.

#### **Article 7**

##### **Notification of the evaluating jury members regarding the conflict of interest**

1. The members of the evaluating jury are informed in advance of the restrictions which derive from the laws in force for the prevention of conflict of interest, as well as with the names of the applicants and authors participating in the competition.

2. If it is ascertained that in a category of the relevant competition there is or may be a conflict of interest among one or two members of the jury, then they are excluded from the evaluation and discussion for the relevant category and are not compensated for their work in that

ličnosti iz oblasti kinematografije: reditelji, producenti, glumci, scenaristi, montažeri, direktori fotografije, književni kritičari, filmski kritičari, kompozitori, pisci, publicisti, filmski stvaraoci i drugi, koji mogu biti domaći i strani.

2. Sastav ocenjivačkih žirija objavljuje se na zvaničnom sajtu KCK-a.

#### **Član 7**

##### **Obaveštenje članova ocenjivačkog žirija u vezi sa sukobom interesa**

1. Članovi ocenjivačkog žirija se unapred upozoravaju na ograničenja, koja proizilaze iz važećih zakona o sprečavanju sukoba interesa, kao i za imena prijavljenih aplikanta i autora koji učestvuju na konkursu.

2. Ako se u nekoj kategoriji relevantnog konkursa utvrdi da postoji ili može postojati sukob interesa kod jednog ili dva člana žirija, isti se isključuju iz ocenjivanja i rasprave za odgovarajuću kategoriju i ne dobijaju naknadu za rad u tu kategoriju.

<p>3. Nëse në një kategori përkatëse konstatohet se ka apo mund të ketë konflikt interesi ndërmjet anëtarëve të jurisë atëherë të njëjtit përjashtohen nga juria dhe duhet të zëvendësohen me anëtarë të rinj.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>Mbledhjet e jurive vlerësuese</b></p> <p>1. Mbledhjen e jurisë vlerësuese e thërret drejtori i QKK-së.</p> <p>2. Juria kompensohet financiarisht për punën e saj: leximin e skenarëve dhe dokumentacionit përcjellës, përfshirë edhe pjesëmarrjen në takime.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Kompensimi i jurive vlerësuese</b></p> <p>1. Kompensimi për filma të metrazhit të gjatë dhe koproduksion minor është në shumën 120.00€.</p> <p>2. Kompensimi për filma të metrazhit të shkurtër artistikë, të animuar dhe dokumentar është në shumën 70.00€.</p> <p>3. Kompensimi për film të metrazhit të gjatë dokumentar është në shumën 80.00€.</p>	<p>category.</p> <p>3. If it is ascertained that in a relevant category there is or may be a conflict of interest among members of the jury, then they are excluded from the jury and must be replaced with new members.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 8</b> <b>Evaluating jury meetings</b></p> <p>1. The meeting of the evaluating jury is called by the Director of the KCC.</p> <p>2. The jury shall be financially compensated for their work as follows: reading the screenplays and accompanying documentation, including participation in meetings.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Compensation of evaluating juries</b></p> <p>1. Compensation for feature-length films and minor co-productions is in the amount of 120.00 €.</p> <p>2. Compensation for short artistic, animated and documentary films is in the amount of 70.00 €.</p> <p>3. The compensation for a feature-length documentary film is in the amount</p>	<p>3. Ako se u relevantnoj kategoriji utvrdi da postoji ili može postojati sukob interesa između članova žirija, oni se isključuju iz žirija i moraju biti zamenjeni novim članovima.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 8</b> <b>Sastanci žirija za ocenjivanje</b></p> <p>1. Sastanak žirija za ocenjivanje saziva direktor KCK-a.</p> <p>2. Žiri dobija novčanu nadoknadu za svoj rad: čitanje scenarija i prateće dokumentacije, uključujući prisustvo na sastancima.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Kompensacija žirija za ocenjivanje</b></p> <p>1. Kompensacija za dugometražne filmove i manje koprodukcije je u iznosu od 120,00 €. €.</p> <p>2. Kompensacija za kratkometražno umetničke, animirane i dokumentarne filmove je u iznosu od 70,00 €.</p> <p>3. Naknada za dugometražni dokumentarni film iznosi 80,00 €.</p>
---	--	---

<p>4. Kompensimi për zhvillim skenari për film të metrazhit të gjatë, për zhvillim të projektit për film të metrazhit të gjatë, postproduksion për film të metrazhit të gjatë, është në shumën 40.00€;</p> <p>5. Kryesuesi i jurisë vlerësuese i udhëheqë mbledhjet e jurisë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 10 Dokumentimi</b></p> <p>Për çdo mbledhje të jurisë mbahet procesverbal gjithëpërfshirës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 11 Detyrat e jurisë vlerësuese të QKK-së</b></p> <p>1. Juria vlerësuese përzgjedh projektet filmike fituese dhe sugjeron ndarjen e buxheteve bazuar në dosjen e projektit filmik.</p> <p>2. Kryesuesi i jurisë vlerësuese ka të drejtën e thirrjes së takimeve të përbashkëta me komisionin financiar gjatë kohës së vlerësimit të projekteve.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 12 Mënyra e vlerësimit</b></p>	<p>of 80.00.</p> <p>4. Compensation for script development for a feature-length film, for a project development for a feature-length film, post-production for a feature-length film is in the amount of 40.00 €.</p> <p>5. The Chairperson of the Evaluating Jury shall preside over the jury meetings.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 10 Documentation</b></p> <p>Comprehensive minutes shall be kept for each meeting of the jury.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 11 Duties of the KCC evaluating jury</b></p> <p>1. The evaluating jury shall select the winning film projects and suggest the allocation of budget based on the film project file.</p> <p>2. The chairperson of the evaluating jury shall have the right to call joint meetings with the Financial Commission during the time of project evaluation.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 12 Evaluation method</b></p>	<p>4. Kompenzacija za izradu scenarija za dugometražni film, za izradu projekta za dugometražni film, postprodukciju za dugometražni film, je u iznosu od 40,00 €;</p> <p>5. Sastanke žirija vodi predsedavajući ocenjivačkog žirija.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 10 Dokumentacija</b></p> <p>Za svaki sastanak žirija vodi se opsežan zapisnik.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 11 Dužnosti ocenjivačkog žirija KCK</b></p> <p>1. Ocenjivački žiri bira pobedničke filmske projekte i predlaže raspodelu budžeta na osnovu dosijea filmskog projekta.</p> <p>2. Predsedavajući ocenjivačkog žirija ima pravo da saziva zajedničke sastanke sa finansijskom komisijom za vreme evaluacije projekta.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 12 Metoda procene</b></p>
---	--	--



<p>1. Juria vlerësuese vlerëson dhe rendit projektet me pikë.</p> <p>2. Numri maksimal i pikëve përcaktohet nga numri i projekteve pjesëmarrëse, p.sh. nëse janë pjesëmarrëse 30 projekte për vlerësim atëherë vlerësimi maksimal është 30 pikë për vendin e parë, 29 pikë për vendin e dytë, 28 pikë për vendin e tretë, 27 pikë për vendin e katërt, e kështu me radhë deri te projekti i fundit.</p> <p>3. Pikët e secilit anëtar mblidhen dhe japin totalin e pikëve të fituara nga projekti përkatës.</p> <p>4. Në rast nevojë, juria vlerësuese mund ta ftojë për prezantim më të hollësishëm (pitching) listën e ngushtë të projekteve me më së shumti pikë.</p>	<p>1. Projects shall be evaluated and ranked according to the points given by the evaluating jury.</p> <p>2. The maximum number of points is determined by the number of participating projects, e.g. if 30 projects are participating for evaluation, then the maximum evaluation is 30 points for the first place, 29 points for the second place, 28 points for the third place, 27 points for the fourth place, and so on until the last project.</p> <p>3. The points of each member are added up and comprise the total points earned by the respective project.</p> <p>4. If necessary, the evaluating jury may invite the shortlisted projects with the most points for a more detailed presentation (pitching).</p>	<p>1. Ocenjivački žiri ocenjuje i rangira projekte poenima.</p> <p>2. Maksimalan broj bodova određen je brojem projekata koji učestvuju, npr. ako za evaluaciju učestvuje 30 projekata onda je maksimalna ocena 30 poena za prvo mesto, 29 poena za drugo mesto, 28 poena za treće mesto, 27 poena za četvrto mesto, i tako redom do poslednjeg projekta.</p> <p>3. Poeni svakog člana se sabiraju i daju ukupan broj poena koje je zaradio odgovarajući projekat.</p> <p>4. Po potrebi, ocenjivački žiri može pozvati uži spisak projekata sa najviše poena na detaljniju prezentaciju (pitching).</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b> <b>Procedura pas vlerësimit të jurisë</b></p> <p>1. Pasi të ketë bërë vlerësimin dhe renditjen e projekteve, juria vlerësuese takohet me komisionin financiar për të përfunduar listën e projekteve fituese dhe shumat përkatëse.</p> <p>2. Juria vlerësuese dhe komisioni financiar ia paraqet drejtorit listën me projektet e</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 13</b> <b>Procedure following jury evaluation</b></p> <p>1. After evaluating and ranking the projects, the Evaluating Jury shall meet with the Financial Commission to finalize the list of winning projects and the corresponding amounts.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 13</b> <b>Postupak nakon ocenjivanja žirija</b></p> <p>1. Nakon ocenjivanja i rangiranja projekata, žiri za ocenjivanje se sastaje sa finansijskom komisijom kako bi finalizirao listu pobjedničkih projekata i odgovarajuće iznose.</p>

<p>përzgjedhura dhe shumat e përcaktuara të subvencionimit.</p> <p>3. Pas pranimit të listës së projekteve me shumat e subvencionimit drejtori i QKK-së merr vendim për secilin projekt të përzgjedhur.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b> <b>Ruajtja e dokumentacionit të projekteve</b></p> <p>1. Juria vlerësuese ia dorëzon Arkivit të Qendrës Kinematografike listën e plotë të projekteve të shqyrtuara dhe të poentuara.</p> <p>2. QKK-ja arkivon dhe ruan të gjithë dokumentacionin e projekteve.</p> <p>3. QKK-ja ruan procesverbalet e mbledhjeve të jurive vlerësuese.</p>	<p>2. The evaluating jury and the Financial Commission shall present the list of selected projects and the determined subsidy amounts to the Director.</p> <p>3. After receiving the list of projects with the subsidy amounts, the Director of KCC shall make a decision for each selected project.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 14</b> <b>Project documentation storage</b></p> <p>1. The evaluation jury shall submit the complete list of reviewed and scored projects to the Cinematography Center Archive.</p> <p>2. KCC shall archive and store all project documentation.</p> <p>3. KCC shall keep the minutes of the evaluating jury meetings.</p>	<p>2. Ocenjivački žiri i finansijska komisija dostavljaju direktoru listu odabranih projekata i utvrđene iznose subvencije.</p> <p>3. Nakon prijema liste projekata sa iznosom subvencije, direktor KCK donosi odluku o svakom odabranom projektu.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 14</b> <b>Čuvanje projektne dokumentacije</b></p> <p>1. Ocenjivački žiri dostavlja Arhivu Kinematografskog centra kompletnu listu pregledanih i ocenjenih projekata.</p> <p>2. KCK arhivira i čuva svu projektnu dokumentaciju.</p> <p>3. KCK čuva zapisnike sa sastanaka žirija za ocenjivanje.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b> <b>Shfuqizimi</b></p> <p>Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja (MKRS) Nr. 08/2016 për Punën e Jurisë Vlerësuese për Projektet Filmike që Subvencionohen nga Qendra Kinematografike e Kosovës dhe çdo akt tjetër nënligjor që bie ndesh me</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 15</b> <b>Repeal</b></p> <p>Upon entry into force of this Regulation, Regulation (MCYS) No. 08/2016 on the Work of the Evaluating Jury for Film Projects Subsidized by the Kosovo</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 15</b> <b>Stavljanje van snage</b></p> <p>Stupanjem na snagu ove Uredbe, stavlja se van snage Uredba (MKOS) br. 08/2016 o Radu žirija za ocenjivanje filmskih projekata subvencionisanih od strane</p>

<p>këtë rregullore.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 16</b> <b>Hyrja në fuqi</b></p> <p>Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: right;">Hajrulla Çeku</p> <p style="text-align: center;">_____ Ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit</p> <p style="text-align: right;">Datë: ____. _____.2023</p>	<p>Cinematography Center and any other by-law that contradicts this Regulation shall be repealed.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 16</b> <b>Entry into force</b></p> <p>This Regulation shall enter into force seven (7) days after its publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Hajrulla Çeku</p> <p style="text-align: center;">_____ Minister of the Ministry of Culture, Youth and Sports</p> <p style="text-align: right;">Date: ____. _____.2023</p>	<p>Kinematografskog centra Kosova i svaki drugi podzakonski akt koji je u suprotnosti sa ovom uredbom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 16</b> <b>Stupanje na snagu</b></p> <p>Ova Uredba stupa na snagu sedam (7) dana od dana objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Hajrulla Çeku</p> <p style="text-align: center;">_____ Ministar Ministarstva kulture, omladine i sporta</p> <p style="text-align: right;">Datum: ____. _____.2023</p>
--	--	---